




ZYRA PËR INFORMIM

Zyra për Informim, gjatë periudhës raportuese, janar-shtator 2024, ka vazhduar me përcjelljen e aktiviteteve ditore të Komunës së Rahovecit. Përmes vegzës zyrtare: <http://kk.rks-gov.net/rahovec>.

Në webfaqen e Komunës janë publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtuara dhe janë publikuar të gjitha vendimet, raportet, njoftimet, konkurset dhe dokumente tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjellur njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa etj.

Gjatë muajve janar- qershor 2024 janë publikuar: aktivitete-dokumente, detajet mund t'i shihni në tabelën e mëposhtme:

Lajme	Njoftime	Dok financiaree	Thirrje	Konkurse	Plane	Takime/Dë gjime Konsultime	Raporte	Kërkesa QDP	Vendimet e Kryetarit	Aktivitete gjithsej
250	80	12	17	25	14	20	40	24	350	812

Të gjitha vendimet e nënshkruara nga kryetari i komunës gjatë kësaj periudhe raportuese janë dërguar tek zyrtarët përkatës në MAPL dhe janë publikuar në web faqen zyrtare të komunës.

Është bërë plotësimi i dokumenteve-raporteve si nga ministrinë edhe nga OJQ-të e që kanë pasur të bënin me transparencë, performancë dhe llogaridhënie komunale.